



BASHKIA  
TIRANË

**VENDIM**

Nr. 46393 / datë 31.12 2020

**"Për miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re Për Zhvillim Në Njësinë Administrative Pezë, Bashkia Tiranë".**

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b" dhe nenin 23, pika 14 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenin 13, pika "dh" të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); nenin 72 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" (i ndryshuar); Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendimin nr.1, datë 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit; urdhëresën nr.28116, datë 24.07.2017 të Kryetarit të Bashkisë "Për procedurat e hartimit dhe miratimit të planeve të detajuara vendore" (e ndryshuar); urdhrin nr.11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë së Tiranës" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendimin nr.11987/1, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë (i ndryshuar), VKM Nr. 887 datë 24.12.2019 "Për Përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.5779/3 datë 19.03.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e miratimit të planeve të detyruara vendore (PDyV);

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor, për Zonën e Re Për Zhvillim Në Njësinë Administrative Pezë, Bashkia Tiranë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbardhjen e dokumentacionit përfundimtar dhe hartës.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e këtij vendimi në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETAR

ERION VELIAJ

